



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 8346 Prot

Gjirokastrë më, 31/07 2026

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 30.07.2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 30.07.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më 30.07.2026 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet pranë UNED . Mbledhja fillon në orën 12:15.

Marrin pjesë në mbledhje 15 anëtarë prezent dhe 1 online (Etleva Kondi). Mungojnë në mbledhje këshilltarët Rova , Shehaj, Leskaj, Aliko, Qeli ,Novi, Erion Shehaj, Llogo ,Drasa, Cacaj , Mahmutaj, Pandos, Cabeli, Binozi.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës si më poshtë:

1. Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 30/06/2026 ora 12:00 si dhe . miratimin e procesverbalit të mbledhjes jashtë rradhe së datës 20/07/2026 ora 12:00
2. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin korik 2026."
3. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin korrik 2026".
4. P/Vendim" Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Gjirokastrë dhe miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e tij"
5. P/Vendim " Për transferimin e fondeve për projektin " CROSS" , "CERV", "ECOBASE" dhe "CHERRY"
6. P/Vendim " Për një ndryshim në VKB-në Nr. 63, datë 02.09.2025 " Për planin e menaxhimit për Transportin Publik të Vizitorëve të Huaj dhe Vendas në Bashkinë Gjirokastrë".
7. P/Vendim " Për marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar vendor (PDV) për njësinë strukturore Z.E.3.2"
8. P/ Vendim " Për hartimin e planeve të detajuara vendore (PDV) për njësitë strukturore Z.E.3.1, Z.U.5.1.A. TËRHIQET NGA APARATI PIKA 8 ME KËRKESËN E BËRË NGA ZYRA E URBANISTIKËS.



Znj. Isaraj pasi lexon rendin e ditës njofton këshilltarët se ka dhe disa pika që nuk janë shënuar te rendi i ditës që kanë të bëjnë me :

- P/Vendim “Për miratimin e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë që do të jepen në përdorim/ qira për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, pemtarisë, blektorisë dhe agroturizmit”.
- P/Vendim “Për një shtesë në VKB-në nr.101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.
- P/Vendim “Për shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.
- P/Vendim “Për Mbarimin e mandatit të Këshilltarit, Znj. Lindita Rova në zbatim të nenit 49 të Ligjit 189/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe fillimi i procedurave për zëvendësimin e saj.
- P/Vendim “Për shqyrtim dhe miratim në parim të “DESTIN – Strategic Call, Program: 629, Priorities: 3, Call Code: 5th gr-AL 4.6.1 (No.: 22827)”.

Znj. Isaraj hedhim në votim miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastrë për rendin e ditës që propozova ?

Miratohet me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online futja e pikave së mësipërme në rendin e ditës.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës që është :

Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 30/06/2026 ora 12:00 si dhe . miratimin e procesverbalit të mbledhjes jashtë radhe së datës 20/07/2026 ora 12:00

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro pika e parë e rendit të ditës.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e II dhe III e rendit të ditës që është :

P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin korik 2026."

P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin korrik 2026".

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e IV e rendit të ditës që është :



P/Vendim” Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Gjirokastrë dhe miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e tij”

Z. Brahimi: Më falni 1 minutë që të mos flasim të gjithë njëherësh, ne si këshill nuk kemi pas probleme as me komisaratin e asnjë të marim ne vendim që shefi i komisarimit të jetë aty më duket se është jashtë kompetencave tona.

Znj. Bezhani: Këshilli Vendor i sigurisë Publike është një mekanizëm kordinues dhe këshillimor që kryesohet nga kryetari i bashkisë. Qëllimi është marja e vendimeve në funksion të rendit dhe sigurisë publike.

Këshilli funksionon në zbatim të VKM 678 të vitit 2024.

Znj. Isaraj: ka dikush dicka tjetër?

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e V e rendit të ditës që është :

P/Vendim “ Për transferimin e fondeve për projektin “ CROSS” , “CERV”, “ECOBASE” dhe “CHERRY”

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e VI e rendit të ditës që është :

P/Vendim “ Për një ndryshim në VKB-në Nr. 63, datë 02.09.2025 “ Për planin e menaxhimit për Transportin Publik të Vizitorëve të Huaj dhe Vendas në Bashkinë Gjirokastrë”.

Z. Brahimi: Ne nuk po zgjidhim dot problemin e transportit public Brenda qytetit, kemi një lagje, Lagjen Cfaq , vajti 6 muaj pa shërbim. Ka pensionista ka njerëz të sëmurë, të zgjidhim njëherë këtë problem pastaj të mendojmë për turistat.


Znj. Lelaj: Bashkia mer përsipër këto 3 linja sikurse janë pasqyruar dhe në matërial, për Lagjen Cfaq janë testuar dhe është e pa mundyr që këta autobuzë të kalojnë dhe të ngjiten te Ura e Zerzebilit. Qëllimi është që ti shërbejnë turizmit por nuk ndalohen që të hipin dhe vendasit.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e VII e rendit të ditës që është

P/Vendim “ Për marrjen e nismës për hartimin e planit të detajuar vendor (PDV) për njësinë strukturore Z.E.3.2”

Znj. Inaraj: Ka ndonjë pyetje?



Z. Brahimi: Kërkoj një sqarim se ne e kemi miratuar në këshillin e mëparshëm planet e zhvillimit. Konkretisht çfarë presupozon kjo?

Znj. Lelaj: Aktualisht Gjirokastra ka një plan të përgjithshëm vendor ku zona të caktuara kanë plane të detajuara vendore. Ne kemi mbyllur 3 zona ekonomike dhe keto janë zona me prioritet pasi ka kërkesa për këto zona për ndërtim dhe zhvillim.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e VIII e rendit të ditës që është:

P/ Vendim “ Për miratimin e sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor në pronësi të Bashkisë Gjirokastër që do të jepen në përdorim/ qira për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, pemtarisë, blektorisë dhe agroturizmit”.

Z. Brahimi: Deri më sot këto prona si janë trajtuar dhe a janë të kontraktuara nga bashkia?

Z. Nebiaj: Bashkëlidhur relacionit është dhe studimi ekonomik që ka kryer Agjencia e Pyjorës dhe momentalisht këto sipërfaqe nuk i janë dhënë askujt dhe një nga këto sipërfaqe që është pyll vitin e kaluar është djegur dhe subjekti që ka bërë kërkesën ka marrë përsipër dhe mbjelljen dhe pyllëzimin e kësaj sipërfaqe. Kjo sillet në këshill për tu miratuar në parim dhe pastaj administrata të kryej procedurat e tjera ligjore.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e IX e rendit të ditës që është:

P/Vendim “Për një shtesë në VKB-në nr.101 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.

Z. Brahimi: Klani i trasmetonte ndeshjet falas pse duhet të paguajmë lekë dhe psi vini tani duhej të merej miratimi i këshillit përpara se të lidhej kontrata.

Znj. Koko: Bashkia Gjirokastër ka lidhur me TV Klan sha , Kontratë Licensimi për ‘Organizimin e Public Screening/Vieëing’ FIFA Eörd Cup 2026, me qëllim ofrimin e shërbimit të marrjes dhe transmetimit të sinjalit televiziv për transmetimin e ndeshjeve të futbollit nga data 19 qershor deri në datën 20 korrik 2026. Vlera totale e kësaj kontrate është 600,000 lekë më TVSH, e parashikuar të shlyhet pjesërisht nga buxheti i bashkisë dhe pjesërisht nga sponsorizimi nga kompania ALFA Sh.a.

Me kontratën e bashkëpunimit për sponsorizim Nr 7090 prot, datë 01.07.2026, të lidhur midis Bashkisë Gjirokastër dhe ‘ALFA’ sh.a’, është rënë dakort sponsorizimi në shumën 300,000 lekë nga kjo e fundit, për shlyerjen e detyrimit për kontratën e sipërpërmendur me TV Klan.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e X e rendit të ditës që është:

P/Vendim “ Për shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 101, datë 22.12.2025 “ Për miratimin e programit afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”. Këtu kemi integruar dhe pikën 8 që ishte te rend i ditë dhe votuam në fillim të mbledhjes për ta hequr.

Z. Muho: tani këto pikat shtes pse nuk vinë në kohë që të kalojnë dhe në komisione.

Znj. Isaraj: kanë kaluar në komisjonë të gjitha pikat.

Arta ndonjë sqarim?

Znj. Koko: Janë materiale të cilat kanë ardhur pasi është miratuar rendi i ditës përshëmbull për materialin që referova më sipër shkresa ka ardhur ditën e hënë të kësaj jave dhe pagesa duhet të bëhet brenda datës 31.

Pjesa tjetër bëhet fjalë për një projekt të fituar për rikonstruksionin e shkollës Cajupi , ku Ministria e Arsimit merr përsipër të financojë 142 milion dhe bashkia 25 milion lekë ku gjithë projekti është 167 milion lekë dhe fond ii akorduar ka ardhë jo më larg se data 23 dhe për shkak të procedurave të prokurimit rezikohet të digjet ky fond.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e XI e rendit të ditës që është:

P/Vendim “ Për Mbarimin e mandatit të Keshilltarit, Znj. Lindita Rova në zbatim të nenit 49 të Ligjit 189/2015 “ Per veteqeverisjen vendore” dhe fillimi i procedurave për zëvendësimin e saj.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e XII e rendit të ditës që është:

P/Vendim “Për shqyrtim dhe miratim në parim të “DESTIN – Strategic Call, Program: 629, Priorities: 3, Call Code: 5th gr-AL 4.6.1 (No.: 22827)”.

Hidhet në votë dhe miratohen me 15 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 16 vota pro.

Znj. Isaraj , nëse nuk gjë tjetër për të shtuar ju falenderoj dhe e mbyllim këtu këtë mbledhje.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Bexhet BAXHELLA

KRTETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ